

STATUTI
i shoqerise Tregtare "ERA - DIGITAL" SH.P.K.

Shoqeria tregtare " ERA - DIGITAL " sh.p.k. themelohet sot ne date 01 nentor 2019, ne baze te Ligjit nr 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Kapitulli I
Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Shoqeria " Era - Digital " shpk, është një person juridik.

Kompania fiton statusin ligjor nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Ajo e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe dispozitat e parashikuara në statut dhe ne aktin e themelimit.

Neni 2

Kompania " Era - Digital " shpk., është një kompani me përgjegjësi të kufizua, me seli Elbasan,Lagjja Kala, rr."Kol Papajani" nr.42, pasuria me nr 15/74 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8524,nr prones 218.

Kompania ka kopetenca të hapë dhe të mbyllë filiale, agjenci apo degë të tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 3

Kohëzgjatja e kompanisë është caktuar pa afat , përveç rasteve kur aksioneri i vetëm vendlon mbylljen e saj.

Neni 4

Emri i kompanisë do të " Era - Digital " shpk.


Ky emertim do te vendoset në të gjithë korrespondencën, në fature në promocione, në reklama, e ndjekur nga inicialet sh.p.k. (shoqeri me përgjegjësi të kufizuar), dhe nga NIUS, qe jepet nga QKR.

Kapitulli II
Aktiviteti

Neni 5

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt:

Prodhim, transmetimin dhe ritransmetimin audioviziv te programeve dhe informacioneve te cdo



Iloji. Cdo aktivitet tjeter qe konsiderohet i dobishem nga organi administrues i shoqerise, qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetin e mesiperm. Ritansmetim audioviziv nepermjet sistemit DVBT-2. Prodhim, blerje, shitje, marrje dhenie me hua te drejtash dhe veprash audiovizive me qellim informim dhe argetim per publikun e gjere audioviziv sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 6

Themeluesit e kompanisë kane të drejtë të ndryshojë në çdo kohë objektin e kompanisë.

Kapitulli III Kapitali i shoqerise

Neni 7

Kapitali i kompanisë është i paguar plotësisht ne mjete monetare nga ana ortakeve dhe është vendosur fillimi në 3.600.000 (tremilionegjashteqindmije) leke.

Kapitali shoqerise perbehet nga 3 kuota , dhe është i ndarë keshtu:

Z. Andrea Asllani zotëron një kuote qe perfaqeson 50% kapitalit te shoqerise, me vlerë nominale 1.800.000 (njemilioneteteqindmije) leke.

Z. Orel Mehja zotëron një kuote qe perfaqeson 34% të kapitalit te shoqerise me vlerë nominale 1.224.000 (njemilionedyqindenjezetekatermije) leke,

Z. Kujtim Hasa zotëron një kuote qe perfaqeson 16% të kapitalit te shoqerise me vlerë nominale 576.000 (peseqindeshtatdhjeteegjashtemije) leke.

Kapitulli IV

Neni 8

Asambleja e ortakeve i ushtron kopetencat e saj në përputhje me ligjin nr 9901 i dates 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Asambleja e ortakeve merr vendime për zhvillimin e aktivitetit, dhe mbi të gjitha për politikën ekonomike dhe tregtare të shoqerise.

Neni 9

Vendimet e asamblese se ortakeve merren duke u bazuar ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.

Asambleja e ortakeve vetëm vendos për çështjet e mëposhtme:

- Miratimi i strukturës organizativa të shoqërisë dhe numrin e njerëzve të punësuar.
- Emëron dhe shkarkon administratorin e shoqerise.
- Administrator i i shoqerise emërohet Z. Andrea Asllani, për një periudhë prej pesë vjetësh.
- Ndryshimet në statutin e shoqerise, të kapitalit aksioner të shoqërisë, ne aktivitetin dhe formën e saj ligjore.

- Vendos per miratimin e llogarive vjetore te pergaitura nga kontabilistet e shoqerise.
- Vendos per mbylljen e shoqërisë, para afateve te parashikuara në aktin e themelimit dhe statutin e saj, ose zgjatjen e afateve te parashikuara ne to.
- Vendos për të zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te shoqerise.
- Riorganizimin, shpërbërjen e shoqerise dhe likuidimin e kesaj te fundit.
- Orientimet mbi bazen e te cilave shoqeria de zhvilloje aktivitetin, politiken ekonomike dhe tregtare te shoqerise.
- Vendos mbi fillimin e aktiviteve te reja sipermarrese dhe tregtare nga ana e shoqerise.
- Vendosë mbi përdorimin e hipotekës, të pengut ose garancive te tjera.

Neni 10

Administratori ka te gjitha kopotencat e nevojeshme per te hyre ne marrëdhëniet me të tretët në emër të kompanisë, pervec kopotencave te parashikuara në ligjin nr 9901 prej 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeria Tregtare".

Administratori është përgjegjës për aktivitetin operativ të shoqerise, dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojeshme për aktivitetet e saj.

Administratori i shoqerise përfaqëson shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe financiare me të tretët, bankat, kompanitë e transportit, etj.

Neni 11

Asambleja e ortakeve emëron deri në dy eksperte kontabel për një periudhë prej 1 vit për të kontrolluar aktivitetin e shoqerise.

Ekspertert kontabel bejne verifikime mbi aktivitetin **financiar** nepermjet kontrolleve periodike, duke u konsultuar me te gjithe dokumentacionin e nevojshem per kryerjen e aktivitetit te tyre.. Dokumentacioni i shoqerise do të vihet në dispozicion të ekspertëve, me qellim permëbushjen e detyrave të tyre.

Kapitulli V Aktiviteti i shoqerise

Neni 12

Viti ekonomiko - finansiar fillon 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Viti i parë do të fillojë në datën e themelimit të shoqërisë.

Pagesa e taksave, tatimeve dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, behen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Llogaritë e kompanisë do të mbahet në lekë dhe në valutë të huaj dhe bilanci do te hartohet në përputhje me ligjin nr 25/2018 të dates 10.05.2018, "Për kontabilitetin"

Neni 14

Punesimi i personelit, kualifikimet e duhura, përcaktimin e pagës për secilin punonjes, dhe shkarkimi i mundshëm i tyre eshte kopetence vetem e administratorit te shoqerise.

Marrëdhëniet e punës midis shoqerise si punëdhënës, dhe personave tev punësuar, do të bazohen në kontratat e punes te parashikuara ne legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KREU VI

Shpërbërja dhe Likuidimi

Neni 15

Shpërbërja e shoqërisë mund të bëhet për shkak të:

- Me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise.
- Në rast të humbjes së gjysma e kapitalit aksioner pasi jane shteruar rezervat.
- Nëse asambleja e ortakeve nuk vendos rritjen e kapitalit ose zvogëlimin sipas legjislacionit.
- Në rast të shpërbërjes së kompanisë procedohet ne likuidimin e saj.
- Asambleja e ortakeve duhet të caktojë një ose më shumë persona përgjegjës për likuidim.
- Likuidimi i kompanisë do të kryhet në përputhje me ligjin nr 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 16

Asambleja e ortakeve duhet të ketë në dispozicion pasqyrat financiare të paktën 15-ditë para mbledhjes të ortakeve për ta miratuar atë.

Dorëzimi i tyre do e behet në selinë e kompanisë.

Administratori duhet te përcaktojë rregulla për të bërë të mundur konsultimin me librat e llogarive të shoqërisë së paku dy herë në vit.

Neni 17

Për gjithcka qe nuk eshte e parashikuar ne kete statut, do te zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.


Ortaket e shoqerise

" ERA DIGITAL " shpk


Andrea Asllani

Handwritten signature of Andrea Asllani in blue ink.

Orel Mehja

Handwritten signature of Orel Mehja in blue ink.

Kujtim Hasa

Handwritten signature of Kujtim Hasa in blue ink.